
**INTERNATIONAL TRADE MEDIATION AS A METHOD OF DISPUTE
RESOLUTION IN INTERNATIONAL LAW**

Fjolla KaproliLaw Faculty, International Balkan University, Skopje, Republic of Macedonia,
fjollakaproli@gmail.com

Abstract: In today's conditions, where economies have open doors all over the world and which conditions operate in the global marketplace, a very important and significant place takes the international trade and the discipline that deals with the study of norms that regulate the way of acting in the international trade for the exchange of goods and services is the International Trade Law. As a result of the liberalization of the world market and as a result of the large number of international trade exchanges of goods and services, the progress and development of enterprises in the national economy, along with the development and advancement of the national economies of the states, proportionally are increasing the importance of this legal discipline. With the exchange of goods and services between subjects in a commercial relationship whether it is a national or international trade exchange and without taking into account the purpose which is to be achieved in that particular commercial relationship, whether it is the sale or purchase of services or goods, are intended to increase their capital. But these cases do not always end with the signing of the legal act and in doing so, with the exchange of goods or services which are the object of that legal act. In these cases, the risk for the appearance of any kind of disputes between the parties is really great. It is not accidental the attempt to escape international trade disputes, which is of common interest to the participants in such trade relations, so that there is as few as possible controversies and disputes between them. But in cases where the interests of buyers and sellers are contradictory, it is pointless to have no disputes at all, so since a dispute cannot be avoided in any way, the same should be resolved. Since judicial procedures in national legislation have a bad background regarding to the inefficiency of case solutions and their unnecessary extensions, theorists and practitioners in recent years have developed several alternative methods for more peaceful and faster solutions to disputes in general and international trade disputes in particular such as arbitration and mediation as two methods that are most important and most often used in practice. The object of this scientific paper firstly will be the elaboration of international trade disputes and then the resolution of disputes that arise in that field by alternative methods of dispute resolution with particular emphasis on the mediation. The implementation of mediation in the resolution of international trade disputes is of special importance for international trade law, it is voluntary and as such during dispute resolution, time is the first aspect and then comes money as the second aspect that are also saved during resolution of disputes through mediation, because mediation provides solution of disputes with small amount of expenses or sometimes it can be said that that amount of expenses look symbolic compared to court expenses.

Keywords: International Trade Law, International Trade Dispute, Alternative Dispute Resolution methods, Mediation

**MEDIJACIONI NDËRKOMBËTAR TREGTAR SI METOD I ZGJIDHJES TË
KONTESTEVE NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE****Fjolla Kaproli**Fakulteti i Drejtësisë, Univerziteti Ndërkombëtar Balkanik-Shkup, Republika e Maqedonisë,
fjollakaproli@gmail.com

Abstrakt: Në kushtet e ditëve të sotme, ku ekonomitë i kanë dyertë e hapur në gjithë botën dhe të cilët kushte funksionojnë në tregun global botërorë, vend të rëndësishëm dhe kyç zen tregtia ndërkombëtare dhe dicitelina e cila merret me studimin e normave të cilët rregullojnë mënyrën e të të vepruarit në tregtinë ndërkombëtare për shkëmbimë të mallrave dhe të shërbimeve është e Drejta Ndërkombëtare Tregtare. Si rezultat i liberalizimit të tregut botëror dhe si rezultat i numrit të madh të shkëmbimit ndërkombëtarë tregtar të mallrave dhe të shërbimeve, si pasojë kanë përparimin dhe zhvillimin e ndërmarjeve në ekonominë nacionale, paralelisht edhe zhvillimin dhe përparimin e ekonomive nacionale të shteteve, të cilët proporcionalisht i'a rrisin rëndësinë kësaj dicitelinë juridike. Me shkëmbimin të mallrave dhe të shërbimeve në mes të subjekteve në një marrdhënie tregtare pa marr parasysh se a bëhet fjalë për shkëmbim tregtar nacional apo ndërkombëtarë dhe pa marrë parasyshë qëllimi i cili dëshirohet të arrihet në atë marrdhënie të caktuar tregtare qoftë ajo shitja apo blerja e shërbimeve apo mallrave, kanë për qëllim

rritjen e kapitalit të tyre. Por këto raste jo gjithmonë përfundojnë me vetë lidhjen e punës juridike dhe në faktë me këtë edhe me shkëmbimin e mallit apo të shrbimit e cila është lëndë apo objekt i punës juridike. Në këto raste rreziku është i madh për paraqitjen e kontesteve në mes të palëve. Jo edhe rastësisht tentohet në ikjen e kontesteve tregtare ndërkombëtare, gjë që është e interesit të përbashkët të pjesmarësve në mardhënien tregtare të tillë, pra të kenë sa më pakë mosmarrëveshje dhe konteste. Por në rastet kur interesat e blerësve dhe shitësve janë në kundërshtim, është e pakuptimtë mosegzistimi i tërësishëm i kontesteve, kështu që pasi që një kontesti nuk mundet t'i iket në asnjë mënyrë, e njejta duhet të zgjidhet. Pasi që procedurat gjyqësore edhe ne legjislacionet nacionale kanë një "background" të keq për sa i përket mosefikasitetit të zgjidhjeve të lëndëve si dhe përshkak të stërzgjatjes së tyre e panevojshme, teoricientët dhe praktikentët në këto vitet e fundit kanë krijuar dhe zhvilluar njëkohësisht disa metoda alternative për zgjidhje më paqesore dhe më të shpejtë të kontesteve në përgjithësi dhe atyre tregtare ndërkombëtare në veçanti siç janë arbitrazhi dhe medijacioni si dy metodat më të rëndësishme dhe më shumë të përdorura në praktikë. Lënda respektivisht objekti i këtij punimi shkencor do të jetë së pari, shtjellimi i kontesteve ndërkombëtare tregtare e më pastaj edhe zgjidhja e kontesteve të cilët paraqiten në atë fushë me anë të metodave alternative të zgjidhjeve të kontesteve me theks të veçantë në medijacionin. Zbatimi i medijacionit në zgjidhjen e kontesteve tregtare ndërkombëtare është e rëndësishë të veçantë për të drejtën ndërkombëtare tregtare, gjithashtu është vullnetare dhe si e tillë gjatë zgjidhjeve të kontesteve, koha është ajo e cila kursehet si pikë e parë e pastaj edhe shpenzimet të cilët në procedurë gjyqësore do të ishin shumë më të larta, ndërsa nga ana tjetër medijacioni mundëson që të njejat të jenë shumë më të vogla dhe ndonjëherë mundet të thuhet edhe të duken simbolike në krahasim me shpenzimet gjyqësore.

Fjalë kyçe: E Drejta Ndërkombëtare Tregtare, Kontest ndërkombëtar tregtar, Metoda Alternative të zgjidhjeve të kontesteve, Medijacioni

KONTESTET NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE TREGTARE

Në qarkullimin tregtar në fushën ndërkombëtare, njejtë si në fushën nacionale, nuk mundet të thuhet se janë të pakta marrëveshjet në mes të shteteve, e cila situatë është si rezultat i lulzimit të tregtisë globale në dekadat e fundit. Kjo njëkohësisht ka sjellë në shumzimin e kontesteve tregtare. Përshkak të rritjeve të investimeve dhe tregtisë ndërkufitare me shpejtësinë e dritës, subjektet (shtete, investitor public dhe privat etj) e marrdhënieve të cilët krijohen gjat atyre investimeve apo gjat shkëmbimit ndërkombëtar tregtar të mallrave dhe të shërbimeve, kërkojnë mënyra të përshtatshme për të vendosur për konfliktet apo për shkeljet e supozuara të marrëveshjeve tregtare ndërkombëtare. Karakteri dhe struktura e përbërë dhe e komplikuar e kontesteve tregtare ndërkombëtare gjat zgjidhjes së tyre kërkon një shkallë të lartë të kujdesit. Kjo është kështu pasi që gjat shkëmbimit tregtar, palët të cilët marin pjesë në atë marrdhënie të krijuar insistojnë dhe kanë për qëllim që të risin fitimet dhe beneficionet e tyre financiare, gjë që shkakton konteste mes tyre. Të njejtën situatë e hasim edhe në shkëmbimet tregtare të karakterit ndërkombëtarë. Është e interesit të palëve që të mos krijohen aspak mosmarrëveshje në mes tyre, por edhe kur të njejat të krijohen të insistohet në zgjidhjen e tyre më të shpejtë me qëllim të mos shkaktohet të ngecjes të mëtutjeshme të shkëmbimit të mallrave dhe shërbimeve ndërmjet shteteve tjera të ndryshme, pra insistohet në zgjidhjen e kontestit në një afat shumë më të shkurtër kohor pasi që ai faktor është i rëndësishë enorme për mbarvajtjen e tregtisë ndërkombëtare. "Është fakt i ditur botërisht se secili shtet është tërësisht sovran për përcaktimin e kompetencave të gjykatave të tyre. Gjithmon gjat këtyre përcaktimeve secili shtet mundohet që të ketë kujdes që gjat vendosjes për konfliktet tregtare ndërkombëtare të respektohen disa principe të të drejtës ndërkombëtare tregtare si: mos përzjerja në punët e brendshme të shteteve tjera apo ekzekutimi i detyrimeve kontraktuale"⁴⁷⁰.

Përshkak të natyrës së transakcioneve, natyrës së kontesteve e sidomos lidhshmërisë me elementin e huaj respektivisht atë ndërkombëtarë, rëndësi të veçantë duhet ti kushtohet çështjes të zgjidhjeve të kontesteve ndërkombëtare tregtare. "Gjat viteve zgjidhja e kontesteve transnacionale janë trajtuar ekskluzivisht nga një numër i vogël i të ashtuquajturit "agjencione ndërkombëtare të të drejtës " të cilët janë të njohur për natyrën e ndërlikuar të procedurës gjyqësore ndërkombëtare dhe arbitrazhit "⁴⁷¹. Jo edhe rastësisht për sa i përket këtyre dy metodave të zgjidhjeve të kontesteve, qendra apo agjenci të cilët miren me zgjidhjen e kontesteve ndërkombëtare tregtare konsiderohen si qendra dhe agjensi të cilët kanë të punësuar persona me pregaditje të lartë në këto sfera. Mirpo në këtë dekadën e fundit vërehet një ekzpanzion i madh i teknikave tjera të cilët ofrojnë zgjidhje shumë më të shpejta dhe më efektive të zgjidhjeve të kontesteve ndërkombëtare tregtare të cilët karakterizohen për nga vullnetarizmi i tyre

⁴⁷⁰ Јездић Михајло, Меѓународно Приватно Право, Београд, 1965, fq. 163

⁴⁷¹ Coombe, George W. Jr. (1999) "The Resolution of Transnational Commercial Disputes: A Perspective from North America," Annual Survey of International & Comparative Law: Vol. 5: Iss. 1, Article 3, fq. 14

si dhe me rritjen e besimit në tregti. Si metoda të tilla njihen: negociatat, medijacioni, pajtimi dhe mini senacat gjyqësore. Medijacioni kohët e fundit është popullarizuar mjaft si metod e zgjidhjeve të kontesteve nga sfera ndërkombëtare tregtare. Kjo përshkak të asaj se siguron efikasitet të zgjidhjes së problemit, ku palët përshkak të obligimeve të tepërta dhe mungesës shumë të madhe të faktorit “kohë” në ditët e sodit, preferojnë zgjedhjen e medijacionit si metodë për të zgjidhur një kontest të tyre. Ligji për Medijacionin parasheh mundësinë e trajtimeve dhe zgjidhjeve të kontesteve ndërkombëtare të çfarëdo lloji natyre por me kusht që të jetë e lidhur me elementin e huaj dhe atë: nëqoftë se palët në momentin e arritjes të marrëveshtjes për medijacion kanë venqëndrim ose seli në ndonjë shtet të huaj, nëqoftë se ndonjë nga obligimet e palëve të cilët rrjedhin nga kontrata detyrimore duhet të kryhet në ndonjë shtet tjetër dhe nëqoftë se pala e cila është pjesëmarrëse në një marrëdhënie kontestuese i vuan marrëdhëniet në një shtet tjetër⁴⁷². Është për tu përmendur fakti se shumë shtete të cilët janë anëtarë të Unionit Europian kanë filluar me të madhe që ti miratojnë dhe ti pranojnë rregullat për medijacion kontraktual. Klauzola e medijacionit kontraktual përcakton kushtet dhe çështjet të cilët konsiderohen të rëndësishme të madhe për nisjen, zbatimin dhe përfundimin dhe me këtë edhe rezultatin përfundimtar të medijacionit. Si çështje e parë e cila është e rëndësishme për medijacionin është përcaktimi i kohës së duhur për nisjen dhe ndërprejren e medijacionit. Gjat përcaktimit të kohës së duhur për zbatim të medijacionit, palët gjithmon duhet të nisen nga ajo se a mundet që ti sigurojnë dokumentet dhe provat të cilët mundet tu nevojiten gjat procedurës së medijacionit dhe a mundet ti përballojnë shpenzimet të cilët mundet të shkaktohen si rezultat i sigurimit të tyre⁴⁷³. Çështja e njohjes së mirë të të drejtës materiale por edhe ligjit të medijacionit të cilët e rregullojnë këtë materie në legjislatcionet nacionale të secilit shtet individualisht dhe e cila duhet të aplikohet gjat medijacionit është e lidhur ngushtë me përcaktimin e kohës të medijacionit. Kjo është kështu pasi që njohja jo shumë e mirë e ligjit e cila duhet të përdoret për zgjidhjen e kontestit në fakt e ngadalson nisjen e zbatimit të medijacionit dhe me këtë edhe ngadalson dhe e zvarrit gjetjen e zgjidhjes të duhur duke u bazuar në ligj jo të duhur. Është kështu nga shkak se bëhet fjalë për konteste tregtare tek të cilët e pranishme është element i huaj. Vendi ku do të zbatohet medijacioni dhe gjuha në të cilën do të kryhet medijacioni janë gjithashtu çështje të rëndësishme të madhe. Ligji për Medijacionin i Republikës së Maqedonisë nuk përmban ndonjë nen e cila e rregullon çështjen e vendit ku do të mbahet dhe zbatohet procedura e medijacionit. Por nga ana tjetër egzistojnë rregullat e ndërkombëtare të cilët rregullojnë çështjen e tillë teknike. Instituti për Parandalimin dhe Zgjidhjen e Konfliktëve⁴⁷⁴ në rregulloren për rregullimin e procedurë të medijacionit më saktë në nenin 3.4 pika b), parasheh se medijatori përcakton kohën dhe vendin për çdo seancë. Edhe pse jo të gjithë ligjet apo rregulloret përfshijnë një nen të tillë e cila do të rregullonte çështjen e vendit ku do të mbahen seancat e medijacionit, mundet të prezumohet se medijatori është ai i cili do të propozoj një vend të përshtatshëm për palët në rradhë të parë e pastaj edhe për vete si përmbushës i obligimeve të cilët i përcaktohen me ligj. Ndërsa sa i përket gjuhës e cila do të përdoret gjat seancave të medijacionit, është një pikë shumë e rëndësishme e cila vlen të trajtohet, pasi që në këtë pjesë shtjellohen kontestete tregtare me element të huaj, pra të cilët kanë lidhshmëri me dy e më tepër shtete të ndryshme me kultura dhe gjuhë të ndryshme. Çka do të ndodh në këto raste? Ligji jon për medijacionin në nenin 4 parasheh rastet kur kemi medijacion ndërkombëtar ndërsa në alinenë e dytë të këtij neni urdhëron në zbatimin e ligjit të Republikës së Maqedonisë në qoftë se procedura e medijacionit zbatohet në shtetin tonë. Kjo gjë automatikisht na çon në përdorimin paralel të neneve të Kushtetutës të Republikës së Maqedonisë⁴⁷⁵ dhe në Ligjin për procedurë kontestimore⁴⁷⁶ të cilët parashohin se gjuha zyrtare e në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare është gjuha maqedone dhe shkrimi kirilik, dhe se gjuhë tjetër e cila flitet nga së paku 20% e qytetarëve gjithashtu konsiderohet si gjuhë zyrtare dhe shkrimi i saj. Çka don të thotë kjo? Nëqoftë se në Republikën e Maqedonisë zbatohet medijacioni e cila ka lidhshmëri me elementin ndërkombëtarë atëherë si gjuhë e cila do të përdoret gjat zbatimit të medijacionit do të jetë gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj kirilik. Në qoftë se ndonjëra nga palët dëshiron që të përdor gjuhën e tij gjat seancës të medijacionit, atëherë sipas nenit 93 al. 3 të Ligjit për procedurë kontestimore të njejtij do ti sigurohet përkthyes në gjuhën e tij. Janë të shumta dokumentete ndërkombëtare të cilët e rregullojnë problematikën e gjuhës gjat medijacionit ndërkombëtar. Kështu, rregullorja e cila i rregullon mënyrat e zgjidhjeve alternative të kontesteve e Odës Ndërkombëtare Tregtare parasheh se gjuha e cila do të përdoret gjat medijacionit ndërkombëtarë përcaktohet me anë të marrëveshtjes të palëve, ndërsa në

⁴⁷² Neni 4, al. 1 i Ligjit për Medijacioni

⁴⁷³ Arthur W. Rovine, Contemporary Issues in International Arbitration and Mediation: The Fordham Papers 2010, Martinus Nijhoff Publishers, Leiden-Boston, 2011, fq 389

⁴⁷⁴ I themeluar në vitin 1977, si një organizatë e pavarur jofitimprurëse që ndihmon bizneset globale të parandalojnë dhe zgjidhin mosmarrëveshjet tregtare në mënyrë efektive dhe efikase.

⁴⁷⁵ Amandmani V, al.1 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë

⁴⁷⁶ Neni 6, al.1 i Ligji për procedurë kontestimore

mungesë të asaj marrëveshje është medijatori ai i cili do të vendosë se cila gjuhë do të përdoret⁴⁷⁷. Gjithashtu edhe Qendra Ndërkombëtare për zgjidhje të kontesteve në rregulloren e cila rregullon Procedurën e zgjidhjeve të kontesteve ndërkombëtare parasheh se nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe, gjuha e medijacionit do të jetë ajo gjuhë në të cilën është përpiluar dokumenti që përmbanë marrëveshjen e medijacionit⁴⁷⁸, si dhe Gjykata e Londrës për Arbitrazh Ndërkombëtar në Rregulloren për Medijacionin parasheh se medijatori është ai i cili vendos për gjuhën në të cilën do të zbatohet procedura e medijacionit⁴⁷⁹. Dhe në fund shumë është e nevojshme që në një procedurë të medijacionit pa mar parasyshë kjo a është ndërkombëtare apo jo, palët të zgjedhin një medijator cilësor dhe të pregaditur profesionalisht që i njejtë ta udhëheq dhe përfundoj me rezultat të suksesshëm medijacionin. Njohuritë e medijatorit për çështjet substanciale, njohuritë e medijatorit për ligjet dhe për të drejtën material e cila duhet të aplikohet te rastet, njohuritë e tij për diversitetet kulturore, pasi që në këtë rast kemi të bëjmë me medijacion ndërkombëtar ku si palë paraqiten shtetas të shteteve të ndryshme dhe të cilët u përkasin kulturave të ndryshme, si dhe përvoja e tij në çështje të ndryshme apo të ngjajshme konsiderohen faktorë shumë domethënës dhe të rëndësishëm për një medijator. Përcaktimin e medijatorit e bëjnë palët me anë të marrëveshjes. Këtë e parasheh Ligji për medijacion⁴⁸⁰ por edhe dokumentet ndërkombëtare të cilët e rregullojnë këtë materije⁴⁸¹. Prandaj, “ në medijacionin ndërkombëtar roli dhe autoriteti i medijatorit, rregullat e medijacionit të përzgjedhur dhe metoda e medijacionit që do të përdoret duhet të përcaktohet dhe të sqarohet paraprakisht për palët⁴⁸²”.

PROCEDURA E MEDIJACIONIT

Të gjitha llojet e kontesteve në të cilët në mes të palëve ka një atmosferë të mirë për gjetje të një zgjidhje paqësore të kontestit të tyre dhe si rezultat i të cilës këto konteste marri cilësinë e kontesteve bona-fide, konsiderohen si të përshtatshme për tu zgjidhur me anë të medijacionit. Ajo është edhe shumë procedurë fleksibile pasi që ka aftësinë e gjetjes të një zgjidhje të strukturuar të kontestit. Edhe pse medijacioni gjithmonë shihet nga anësi si një procedurë jashtë hapsirave gjyqësore, ka raste kur e njejtë inicohet edhe gjat rrjedhjes së procedurave gjyqësore, pra “ medijacioni mund të ndodhë në çdo kohë të kontestit ”⁴⁸³. Nëse palët arrijnë në një pikë të procesit gjyqësor ose në arbitrazh, ku ata dëshirojnë të zgjidhin sa më shpejtë kontestin e tyre, ata mund të angazhojnë një medijator për ta arritur këtë qëllim. “ Fillimi i medijacionit është detyra më e vështirë për të arritur, pasi në këtë fazë marrëdhëniet ndërmjet palëve tashmë janë të acaruar ”⁴⁸⁴. Edhe pse konsiderohet një mjedis i përshtatshëm për medijacion, prap se prap kontesti dhe natyra e saj përmban në vete armiqtë si veti. Kështu që palët edhe nëse dakordohen që të zgjidhin kontestin e tyre me anë të kësaj metode të ashtuquajtur paqësore edhe pse marrëdhëniet në mes të palëve janë armiqtë, është mjeshtëri e medijatorit se çfarë lëvizje dhe veprime do të ndërmer dhe se si do të ndërmer ato veprime dhe çfarë sugjerime do të jep vetëm e vetëm të mos tregojë dobësitë dhe pasiguritë e palëve në kontest. Sipas nenit 15 alinesë së parë të Ligjit për Medijacion në Republikën e Maqedonisë, medijacioni nisën në ditën kur palët në kontest arrijnë marrëveshje në formë të shkruar apo japin deklaratë të nënshkruar dhe të regjistruar në procesverbal para gjykatës se do të marri pjesë në medijacion. Pasi që kalohet faza e parë, pra ajo e arritjes së marrëveshjes dhe përcaktimit të medijacionit si procedurë e zgjidhjes të kontestit dhe gjithashtu përcaktimi i mediatorit dhe para se të fillojnë me shqyrtimin e çështjes kryesore e cila paraqitet lëndë e procedurës së medijacionit, palët me medijatorin takohen dhe diskutojnë për çështjet paraprake, modifikimi i procedurës, vendi dhe koha e seancave si dhe çështjen e dokumenteve të cilët palët i kanë dhe të cilët u nevoiten palës kundërshtare. Edhe sipas Ligjit të medijacionit para fillimit të procedurës së medijacionit, medijatori është i detyruar t'i njoftoj palët me qëllimin e medijacionit, rolin e medijacionit, rregullat dhe kostot e procedurës së medijacionit⁴⁸⁵. Është obligim i medijatorit që gjat zbatimit të procedurës të medijacionit të bëjë kujdes kur vjen tek respektimi i parimeve

⁴⁷⁷ Neni 5.4, Rregullorja për medijacion e Odës Ndërkombëtare Tregtare

⁴⁷⁸ Neni 18, Rregullorja e Procedurës për zgjidhjen e kontesteve tregtare e Qendrës Tregtare për zgjidhjen e Kontesteve

⁴⁷⁹ Neni 5.5 i Rregullores për Medijacionin i Gjykatës së Londrës për Arbitrazh Ndërkombëtar.

⁴⁸⁰ Neni 17 al.1, al.2, Ligji për medijacionin

⁴⁸¹ <https://www.cpradr.org/resource-center/rules/international-other/mediation/european-mediation-procedure>

⁴⁸² <https://www.uww-adr.com/zupload/wp-content/uploads/2015/03/International-Mediation.pdf>

⁴⁸³ Dr. Surya P. Subedi DPhil, Barrister, International Trade and Business Law, The people public security publishing house, Hanoi fq. 470

⁴⁸⁴ Ibid

⁴⁸⁵ Shih më tepër në Kreun e Dytë të Ligjit për medijacionin (neni 6-14)

rë medijacionit⁴⁸⁶. Gjithashtu duhet të jetë i kujdesshët pasi që interesi i palëve është ai për të cilën vendoset në procedurë, si dhe duhet ti ketë parasyshë edhe të gjithë rrethanat tjera të cilët do të kontribuojnë në zgjidhjen e shpejtë dhe të suksesshme të kontestit. Medijatori gjithashtu duhet që ti kuptojë pikpamjet e të dyja palëve dhe të takohet me secilën palë në mënyrë private e të dëgjojë pikëpamjet e tyre përkatëse, të zbuloj interesat e tyre të përbashkëta dhe të përpiqet t'i ndihmojë ata të arrijnë një zgjidhje të mosmarrëveshtjes së tyre. Medijacioni kalon nëpër faza të ndryshme të cilët janë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën. Gjat fillimit, zbatimit dhe përfundimit të procedurës së medijacionit, medijatori duhet gjithmon të udhëhiqet me parimet të cilët e karakterizojnë këtë procedurë dhe të cilët janë të parapara shprehimisht në ligj por edhe me dokumentet e ndryshme nërkombëtare. Si parime të tilla janë: parimi i autonomisë të palëve, parimi i barazisë dhe parimi i barazisë të palëve, parimi i neutralitetit dhe paanësisë, parimi i besueshmërisë/konfidencialitetit, parimi i efikasitetit dhe parimi i drejtësisë.

Procedura e medijacionit do të përfundoj me sukses në qoftë se medijatori dhe palët kanë ndërmar hapat e duhura dhe i kanë mbështetur veprimet e tyre në parimet e lartë përmendura të procedurës të medijacionit pa mar parasyshë se është zbatuar procedura në bazë të ligjit të Republikës së Maqedonisë ose ndonjë ligj të ndonjë shteti tjetër apo ndonjë rregullore ndërkombëtare. Instituti ndërkombëtar për Parandalim të Konfliktëve dhe për Zgjidhjen e tyre në rregulloren e saj për Procedurën Ndërkombëtare të Medijacionit parasheh se nëse palët me ndihmën e medijatorit arrijnë një zgjidhje të përbashkët për kontestin e tyre duhet të përpilojnë një dokument në formë të shkruar⁴⁸⁷. Ky dokument ka cilsinë e marrëveshtjes për medijacion e cila përmban të gjithë kushtet e arritjes të marrëveshtjes si dhe të gjithë lirimet apo shkarkimet nga obligimet të cilët kanë lidhshmëri me kontestin e zgjidhur me anë të medijacionit. Mirpo nuk janë të pakta edhe rastet kur palët nuk mundin të arrijnë marrëveshtje me ndihmën e medijatorit për zgjidhjen e kontestit të tyre. Në ato raste medijatori mundet ta diskutoj me palët mundësinë të cilën ato e kanë për të përdorur arbitrazhin ose ndonjë metodë tjetër alternative për të zgjidhur kontestin e tyre. Sipas Ligjit për Medijacionin, procedura e medijacionit përfundon me: arritjen e marrëveshtjes në formë të shkruar në mes të palëve, me deklaratë në formë të shkruar të medijatorit pas konsultimeve me palët nëse medijatori bien ë konkludim se nuk janë të arsyeshme përpjekjet e mëtutjeshme të medijacionit, me deklaratë të shkruar nga ana e palëve drejtuar medijatorit se procedura e medijacionit është e përfunduar, me deklaratë të shkruar nga ana e cilësdo palë në procedurë drejtuar palës tjetër dhe medijatorit se procedura është e përfunduar, me vdekjen e ndonjëris prej palëve në procedurë dhe me ndërprerjen e statutit të medijatorit i cili ka zbatuar procedurën e medijacionit⁴⁸⁸. Ligji për medijacion gjithashtu në nenin 20 në alinenë e dytë parasheh edhe periudhën kohore brenda të cilës medijatori dhe palët duhet t'i ndërmarin veprimet e tyre procedural dhe ta përmbyllin procedurën e medijacionit. Sipas ligjit të vjetër për medijacionin⁴⁸⁹ në nenin 20 alinenë e dytë kjo periudhë kohore ishte më e shkurtrë, më saktë 45 ditë nga dita e dhënies të deklaratës për nisjen e procedurës të medijacionit dhe pa mar parasyshë rezultatin përfundimtar të tij.

MARRËVESHTJET E MEDIJACIONIT

Marrëveshtjet e medijacionit janë të rëndësishë të madhe sidomos në sferën e tregtisë ndërkombëtare të lidhjes të marrëveshtjeve të ndryshme ndërkombëtare për shkëmbimin e mallrave dhe të shërbimeve në përgjithsi si dhe në zgjidhjen e kontesteve ndërkombëtare tregtare në veçanti. Në preambulën e Konventës të Kombeve të Bashkuara për Marrëveshtjet për Zgjidhje Ndërkombëtare që rezultojnë nga Medijacioni⁴⁹⁰, parasheh të nevojshme krijimin e një strukture për marrëveshjet ndërkombëtare të zgjidhjeve të kontesteve që vijnë nga medijacioni dhe të cilët do të jenë të pranueshme për shtetet me sisteme juridike por edhe sociale dhe ekonomike të ndryshme të cilët do të ndikonin në kontribuimin e zhvillimit të marrëdhënieve ndërkombëtare tregtare. Marrëveshtja e medijacionit e arritur nga palët dhe me anë të ndihmës të medijatorit përmban rregulla kontraktuale të cilët rregullojnë çështjen konfliktuale e cila ka qenë objekt i kontestit. Kjo konventë parasheh disa kushte të cilët duhet të plotësohen që të mundet të aplikohet dhe të vlej një marrëveshtje e medijacionit. Të paktën dy palë në marrëveshjen e shlyerjes të kenë selin e bizneseve të tyre në dy shtete të ndryshme dhe shteti në të cilin palët kanë seli të bizneseve të tyre të jetë ndryshe nga shteti në të cilën zbatohet pjesa më e madhe e detyrimeve sipas marrëveshtjes dhe të jetë më ndryshe nga shteti me të cilën objekti i marrëveshtjes me të cilën është zgjidhur kontesti është më ngushtë i lidhur⁴⁹¹. Edhe forma e marrëveshtjes

⁴⁸⁶ al.1, neni 6 i Ligjit për mediacionin

⁴⁸⁷ Neni 7 (Settlement), CPR International Mediation Procedure (2017), effective from March1, 2017

⁴⁸⁸ Neni 20 i Ligjit për Medijacion

⁴⁸⁹ Ligji për Medijacionin, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.138, 17.11.2008

⁴⁹⁰ United Nations Convention on International Settlement Agreements Resulting from Mediation, A/73/17

⁴⁹¹ Neni 1 i Konventës të Kombeve të Bashkuara të Marrëveshtjeve Ndërkombëtare të Zgjidhjeve të cilët rezultojnë nga Medijacioni.

është një çështje shumë e rëndësishme. Sot në tregun ndërkombëtar lidhen kontrata të ndryshme dhe të cilët janë të shumtë dhe të cilët përshkak të shpeshtësisë së tyre dhe lidhjes së përditshme të tyre mundet të lidhen në forma të ndryshme. Si formë primare është ajo e shkruar, por mundet të lidhen edhe në forma tjera si nëpërmjet të telefonit, me anë të korrespondencës apo edhe nëpërmjet të e-mailit e cila sot dukshëm është forma më tepër e përdorur për lidhjen e kontratave. Sipas Ligji të Medijacionit e cila është në fuqi sot, marrëveshtja e medijacionit lidhet në formë të shkruar e përgaditur nga ana e e palëve ose nga ana e medijatorit në bazë të kërkesës së palëve dhe e nënshkruar nga ana e palëve në afat prej 3 ditëve nga dita kur është arritur marrëveshtja për kontestin e tyre⁴⁹². Sipas nenit 2,1 medijatori është i obliguar që marrëveshtjen e tillë ta vërtetoj me nënshkrim dhe të njejtën ta paraqes tek Ministria e Drejtësisë me qëllim që e njejtja të regjistrohet në Regjistrin përkatës për mbajtjen e evidencës për procedurat e medijacionit. Palët mundet që në marrëveshtjen e tyre detyrimore të përcaktojnë disa rregulla të cilët do të obligohen që në rast të paraqitjes të ndonjë kontesti në mes tyre të njejtën ta zgjidhin nëpërmjet të medijacionit⁴⁹³, pra ajo mundet të caktohet edhe para se të inicohet procedurë gjyqësore për zgjidhjen e kontestit. Në këto raste në qoftë se palët arrijnë të miren vesht për kontestin e tyre në procedurë të medijacionit, dhe të njejtë duan që ajo marrëveshtje të ketë fuqinë e dokumentit ekzekutiv, atë marrëveshtje ato duhet ta solemnizojnë në noterë në përputhje me ligjin (neni 22 al. 1), ndërsa në qoftë se procedura e medijacionit zbatohet pas inicimit të procedurës të rregullt gjyqësore, medijatori është i obliguar që pas sjelljes të marrëveshtjes për zgjidhjen e kontestit me anë të medijacionit ta njoftoj gjykatën për menyrën e përfundimit të kontestit dhe të njejtën marrëveshtje ta dorzoj në atë gjykatë e cila do të paraqesë bazë për pajtim gjyqësor.

PËRFUNDIM

Metodat alternative të zgjidhjeve të kontesteve përfshirë këtu edhe medijacionin si lloj i veçantë dhe pranimi i tyre në sistemet gjyqësore bashkëkohore përfshirë këtu edhe të Republikës së Maqedonisë, arsyetohet nga disa argumente. Medijacioni paraqet një procedurë fleksibile për sa i përket rregullave në bazë të të cilave zbatohet procedura. Kjo pasi që vetë palët në procedurën e medijacionit janë dizajner të zgjidhjes së kontestit të tyre si rezultat i marrjes pjesë aktive gjat gjith kohës në procedurë. Ato janë ato të cilët i përcaktojnë rregullat e “lojës”, janë ato të cilët e përcaktojnë medijatorin dhe gjithë çështjet të cilët janë të rëndësishme për mbarvajtjen e procedurës. Procedura e medijacionit për zgjidhje të kontesteve ndërkombëtare përfshirë këtu edhe ato tregtare karakterizohet për zgjidhje të shpejtë të kontesteve dhe kursim të parave në të njejtën kohë. Beneficione për zgjidhje më të shpejtë dhe më të lirë të kontestit përveç se në rradhë të pare kan vetë palët e kontestit, këtu gjithashtu nuk mundet të përjashtohet edhe shteti, pasi që zgjidhja e kontesteve me medijacion i ndihmon atij që të shkarkohet sistemi gjyqësor i tij nga këto lloje të kontesteve, gjë që i ndihmon gjykatatve të ju përkushtohen më shumë lëndëve të natyrave tjera më të komplikuar. Kjo metodë ndikon edhe në rrjedhjen pa pengesë të komunikacionit ndërkombëtar tregtar të shkëmbimit të mallrave dhe të shërbimeve në mes të subjekteve, pasi që mundëson zgjidhje të shpejtë të kontesteve eventuale të cilët mundet të paraqiten gjat qarkullimit ndërkombëtar të transaksioneve. Andaj mendoj se përshkak të nevojës të madhe të informimit të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe tregtarëve në veçanti, është e nevojshme një promovim më i madh i kësaj metode nëpërmjet të mediave, debateve publike në to si dhe mbajtjes të puntorive të vogla të organiuara enkas për qytetarë dhe persona të cilët si profesion kanë tregtinë për tu informuar të njejtët për egzistimin e kësaj metode e cila siguron tejkalimin e situatatve konfliktuoz nëpërmjet të bashkpunimit të palëve dhe arritjes të marrëveshtjes në mes tyre me ndihmën e medijatorit si palë neutrale.

BIBLIOGRAFIA

- [1] Arthur W. Rovine, *Contemporary Issues in International Arbitration and Mediation: The Fordham Papers 2010*, Martinus Nijhoff Publishers, Leiden-Boston, 2011
- [2] Coombe, George W. Jr. (1999) "The Resolution of Transnational Commercial Disputes: A Perspective from North America," *Annual Survey of International & Comparative Law: Vol. 5: Iss. 1, Article 3*
- [3] CPR International Mediation Procedure (2017), effective from March 1, 2017
- [4] Dr. Surya P. Subedi, DPhil, Barrister, *International Trade and Business Law*, The people public security publishing house, Hanoi
- [5] Đurović Radomir, *Međunarodno privredno parvo*, Beograd, 1991
- [6] <https://www.cpradr.org/resource-center/rules/international-other/mediation/european-mediation-procedure>
- [7] <https://www.uww-adr.com/zupload/wp-content/uploads/2015/03/International-Mediation.pdf>

⁴⁹² Neni 21 al. 1 i Ligjit për Medijacionin

⁴⁹³ Neni 3 i Ligjit për Medijacionin

- [8] International Center for Dispute Resolution, International Dispute Resolution Procedure (Mediation and Arbitration Rules)
- [9] Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 08-4642/1, 17.11.1991
- [10] Ligji për Medijacionin, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 188, 31.12.2013
- [11] Ligji për Medijacionin, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr.138, 17.11.2008
- [12] Ligji për procedurën kontestimore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 07, 20.01.2011
- [13] London Court on International Arbitration Mediation Rules
- [14] Mediation Procedure of International Chamber of Commerce
- [15] United Nations Convention on International Settlement Agreements Resulting from Mediation, A/73/17
- [16] Јездић Михајло, Меѓународно Приватно Право, Београд, 1965

